



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

BORDI

VENDIM

Nr. 113, Datë 27.03.2023

MBI

**ZGJATJEN E VENDIMMARRJES SË BORDIT TË ERE-S NË LIDHJE ME
APLIKIMIN E SHOQËRISË “ENERGY MARKET ALBANIA” SH.P.K. PËR
LICENCIM NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 14, pika 3, të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrik, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96 datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 27.03.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 877/6 prot., datë 24.03.2023, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi zgjatjen e vendimmarrjes së bordit të ERE-s në lidhje me aplikimin e shoqërisë “ENERGY MARKET ALBANIA” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e tregimit të energjisë elektrike”,

Konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 59, datë 24.02.2023 vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “ENERGY MARKET ALBANIA” sh.p.k., në veprimtarinë e tregimit të energjisë elektrike.
- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 25.02.2023 dhe 26.02.2023) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 06.03.2023), nuk rezultoi të ketë të tilla. Njoftimi për fillimin e kësaj procedure u botua edhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s.
- Me shkresën nr. 887/4 prot., datë 03.03.2023, ERE i është drejtuar shoqërisë duke i njoftuar fillimin e procedurës dhe duke i kërkuar dokumentacionin e konstatuar të munguar apo të plotësuar pjesërisht. Kjo shkresë është kthyer mbrapsht nga shërbimi postar.

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 887/5 prot., datë 24.03.2023, shoqëria ka depozituar në ERE informacion plotësues të aplikimit dhe po ashtu ka kërkuar mirëkuptimin e ERE-s për të zgjatur afatin e depozitimit nga ana e saj të dokumentacionit plotësues të këtij aplikimi.
- Në nenin 14, pika 3, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” e ndryshuar, parashikohet se bordi mund të vendosë rast pas rasti për zgjatjen e afatit për marrjen e vendimit përfundimtar për pranimin ose refuzimin e aplikimit për licencë kur dokumentacioni nuk është i plotë, por jo më shumë se 30 ditë.
- Me qëllim që të shqyrtohet dokumentacioni i depozituar së fundmi nga shoqëria, çka mund të sjellë nevojën e zhvillimit të një korrespondence të mëtijshme me të, vlerësohet të zgjatet deri në 20 (njëzet) ditë afati i vendimmarrjes së bordit të ERE-s mbi aplikimin e shoqërisë “ENERGY MARKET ALBANIA” sh.p.k. për t’u licencuar në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të zgjasë deri në 20 (njëzet) ditë afatin për marrjen e vendimit përfundimtar për aplikimin e shoqërisë “ENERGY MARKET ALBANIA” sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë shoqërinë për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI